



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodalo Received/Delivery	05-05-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtopja Prilog Appendix	Sasia Kolicema Quantity
SKAMBICK	4123	/2023	113



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr. 448/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 448/2023 të datës 02.03.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "vlerësim i punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.05.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr. 448/2023 të datës 02.03.2023 të parashtruar nga ankuesja

II.Mbetet në fuqi, vlerësimi i rezultateve në punë, për vitin 2022, për nëpunësen civile, Arife Kodraliu nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 02.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar me numër protokoli 2250/2023, me pretendimet ankimore lidhur me vlerësimin vjetor për vitin 2022, të vlerësuar nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.03.2023, ka proceduar kërkesën për

përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme . Ndërsa me datë 14.04.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.03.2023, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 2550/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë; e- maili i datës 14.03.2023; Plani i Punës; e- maili i datës 29.12.2022; e- maili i datës 15.12.2022; e- maili i datës 09.12.2022; e- maili i datës 29.12.2022; e- maili i datës 09.12.2022; e- maili i datës 04.11.2022; e- maili i datës 16.11.2022; e- maili i datës 21.12.2022; e- maili i datës 07.12.2022; e- maili i datës 03.11.2022; e- maili i datës 11.12.2022; e- maili i datës 20.10.2022; e- maili i datës 19.10.2022; e- maili i datës 12.10.2022; e- maili i datës 11.10.2022; e- maili i datës 28.09.2022; e- maili i datës 28.09.2022; e- maili i datës 26.10.2022; e- maili i datës 23.10.2022; e- maili i datës 23.09.2022; e- maili i datës 29.08.2022; e- maili i datës 21.09.2022; e- maili i datës 15.09.2022; e- maili i datës 12.09.2022; e- maili i datës 02.08.2022; e- maili i datës 14.10.2022; e- maili i datës 28.09.2022; e- maili i datës 27.01.2022; e- maili i datës 25.03.2022; Përgjigje në ankesë, me numer protokollit 14.04.2023 e datës 14.04.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesja është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja mban pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Politikave të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Kapaciteteve në Administratën Publike, ndërsa Udhëheqësja e saj e drepërdrejt ankuesen sipas Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 31.01.2023 e ka vlerësuar me notën e përgjithshme mesatare tre pikë dy (3.2) për periudhën kohore nga data 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses sa i përket notës së përgjithshme të vlerësimit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik nën paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku përcaktohet se: *"Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë", ndërlidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 i të njëjtit nen dhe rregullore ku përcaktohet se: " Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: "mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës", prandaj marrë për bazë Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për ankuesen të datës 31.01.2023 përmes të cilat ankuesja ishte rivlerësuar me notë të përgjithshme mesatare (3.2) për periudhën kohore nga data 31.01.2022 deri me datë 31.12.2022, Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se ankuesja është vlerësuar "mirë" në kuptim të dispozitave të lartcekura të rregullores, nga rrjedh si i njëjta vlerësohet se i ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës.*



Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesja është vlerësuar për objektivat e parapara ashtu siç e përcakton Rregullorja në fuqi dhe për objektivat kryesore është vlerësuar në tri prej tyre me notën 3 dhe në një të tjetër me notën 4, që do të thotë se ka arritur objektivat të realizoj në kuadër të përtshmerive.

Prandaj, nga analizimi i shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses sikurse edhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses me rastin e vlerësimit të ankueses me notën e përgjithshme mesatare "3.2, mirë" e që në kuptim të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik vlerësohet se i njëjta i ka arritur të gjitha objektivat punës dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës, prandaj mbi këtë bazë udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 7 të së njëjtës rregullore, ngase ankuesja është vlerësuar edhe për arritjen e objektivave sikurse edhe për sjelljet profesionale, ndërsa ankuesja nuk ka mundur të mbështes pretendimet e tij ankimore se i njëjti është dashur të vlerësohet me notë më të lartë e që në kuptim rregullore së lartcekur pas notës së vlerësimit të ankuesit është nota "shumë mirë" me të cilën mund të vlerësohet nëpunësi civil i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses i paraqitur në ankesën e datës 02.03.2023 të parashtruar në Këshill është i pabazuar, ngase argumentet e saj nuk janë bindësi se i njëjta ka ndikuar në performancën e përgjithshme të institucionit.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr. 448/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së,